



Data:02.06.2026

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.347/350-23717

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14,15,19,20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031 neneve 44,47,48, Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029, 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021 si dhe sipas Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022- 2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, Marrveshjes së Memorandumit të Bashkpunimit Nr.5310/2023.06 datë 17.10.2023 dhe Nr.413101-21371 datë 30.10.2023 nënshkruar në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Federatës së Fudbollit të Kosovës dhe Komunës së Suharekës, si dhe kërkesës 07Nr.350/23717 datë 25.05.2026 dhe dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria për Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë, Komuna Suharekë, DUPM lëshon këtë:

AKTVENDIM (MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Drejtorina për Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350/23717 datë 25.05.2026
Adresa:	Komuna Suharekë		

Emri i Projektit:	Stadiumi i Ri, Suharekë - Kategoria II plus, sipas UEFA
Emri i Projektuesit:	“GM-Architecture”-Studio për projektim dhe konsultim
Adresa:	Rr.”Xhevdet Doda” Dukagjin Center kati 2, Nr.15 10000 Prishtinë
Emaili:	info@gmarchitecture.com

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II plus, sipas UEFA	
Adresa: Rr.”Ardhmëria”-Suharekë	
Zona(t) Kadastrale: Studenqan, sipas çertifikatës se pronës me numër referues 505/2026 datë 25.05.2026, pronë e Komuna e Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale: 02859-1

GPS KOORDINATAT E OBJEKTIT			
TRIBUNA VERIORE		TRIBUNA LINDORE	
Y=7481413.2493954	X= 4689593.48583016	Y=7481423.07835854	X=4689600.30879184
Y=7481416.06112707	X= 4689593.45309144	Y=7481503.24693516	X=4689518.25131761
Y=7481423.07835854	X= 4689600.30879184	Y=7481496.22988211	X=4689511.39579152
Y=7481420.14269771	X= 4689603.31362145	Y=7481416.06112707	X=4689593.45309144
Y= 7481409.37571751	X= 4689603.44014158		
Y= 7481404.54274151	X= 4689598.71639469		
Y= 7481402.23779043	X= 4689601.07464408		
Y= 7481349.99425271	X= 4689550.03371822		
Y= 7481359.16523959	X= 4689540.64664848		

TRIBUNA JUGORE		TRIBUNA PERENDIMORE	
Y=7481506.1464556	X=4689504.2141575	Y=7481357.57828286	X=4689536.26635687
Y=7481506.27382469	X=4689515.1531098	Y=7481338.05082287	X=4689517.18840343
Y=7481503.24693516	X=4689518.25131761	Y=7481417.93713219	X=4689435.41984708
Y=7481496.22988211	X=4689511.39579152	Y=7481437.46459222	X=4689454.49780055
Y=7481496.19584911	X=4689508.47290456		
Y=7481440.55141327	X=4689508.47290456		
Y=7481437.81294004	X=4689454.14124511		
Y=7481437.46459222	X=4689454.49780055		
Y=7481430.26409023	X=4689447.46304837		
Y=7481433.5608966	X=4689444.08856407		
Y=7481444.49758407	X=4689443.98439383		
KORDINATAT E THEMELEVE TE STADIUMIT		KORDINATAT E FUSHES	
Y=7481359.16523959	X=4689540.64664848	Y=7481366.62391396	X=4689538.18350988
Y=7481349.99425271	X=4689550.03371822	Y=7481415.26374101	X=4689585.7036869
Y=7481402.23779043	X=4689601.07464408	Y=7481488.64048494	X=4689510.5980716
Y=7481404.5427415	X=4689598.71639469	Y=7481440.00065789	X=4689463.07789458
Y=7481409.37571752	X=4689603.44014158		
Y=7481420.14269771	X=4689603.31362145		
Y=7481506.27382469	X=4689515.1531098		
Y=7481506.1464556	X=4689504.2141575		
Y=7481444.49758407	X=4689443.98439383		
Y=7481433.5608966	X=4689444.08856407		
Y=7481430.26409023	X=4689447.46304837		
Y=7481417.93713219	X=4689435.41984708		
Y=7481338.05082287	X=4689517.18840343		
Y=7481357.57828286	X=4689536.26635687		
Y=7481437.81294004	X=4689454.1412451		
Y=7481440.55141327	X=4689454.10935925		
Y=7481496.19584911	X=4689508.47290456		
Y=7481496.22988211	X=4689511.39579152		
Y=7481416.06112707	X=4689593.45309144		
Y=7481413.2493954	X=4689593.48583016		

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Objekt sportiv-Stadiumi i Ri Suharekë

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria II plus, sipas UEFA

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore Drejtorisë për Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë, Komuna Suharekë i lejohej ndërtimi i stadiumit të ri të qytetit.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022- 2030, 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale 02859-I me HZK është me destinim Hapësira/komplekse sportive ZrT-3.

Objekti i stadiumit të ri ka karakter të përhershëm, dhe përbëhet nga katër tribuna (veriore, lindore, jugore dhe perëndimore). Ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUPM e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore.

Qasja në parcelë lejohej nga rruga e planifikuar me HZK e cila ka qasje në rrugën ekzistuese dhe atë të planifikuar me HZK, duke i respektuar distancat e qasjeve me rrugët publike sipas UA.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
 - Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
 - Informata mbi Projektuesin.
 - Informata mbi Kontraktuesin.
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
 - Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
- Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore.
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpres punimet dhe të njoftoj menjëherë organin kompetent duke u bazuar në paragrafin 7.6 të nenit 7 të Ligjit Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
 - Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
 - Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi Drejtorisa për Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë, Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/23717 datë 25.05.2026, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e Stadiumit i qytetit me dimensione të fushës së futbollit sipas stadardeve të UEFA-s 68x105 m² dhe kapacitet të ulësve 6500 tërësisht të mbuluara, sipas projektit të bashkangjitur dhe dokumenteve tjera të bashkangjitura.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.126/350-10433 datë 23.03.2026 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.45/2026 datë 03.04.2026 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vërtetim të Ujësjellësit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren datë 07.04.2026.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.79 datë 02.04.2026.
- Pëlqim parimor për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.311, datë 13.05.2026.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri Nr.0005061/26 datë 24.04.2026- Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencia e Menaxhimit Emergjent.
- Aktvendimin e Lejes Mjedisore Komunale 07Nr.286/350-14436 datë 12.05.2026.
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit të datës 14.05.2026 të punuar nga Kompania e licensuar gjeodezike "GeoHorizont" me Nr.Lic.54.
- Marrveshjen e Memorandumit të Bashkpunimit Nr.5310/2023.06 datë 17.10.2023 dhe Nr.413101-21371 datë 30.10.2023 nënshkruar në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Suharekës.
- Një kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Aktvendimin mbi formimin e komisionit profesional 01-Nr.410-24082 datë 26.05.2026 nga Zyra e Kryetarit të Komunës sipas kërkesës 01Nr.104-24067 datë 26.05.2026.
- Raportet e anëtarëve të komisionit konform formularëve standard të udhëzimit administrativ 06/2017 datë 23.05.2017.

Pala lirohet nga pagesa në pajtueshmëri me nenin 8.14.2 të Rregullores 01Nr-16-12102 datë 01.12.2015 për tarfiat, ngarkesat dhe gjambat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.347/350-23717 datë 02.06.2026

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;

Inspektoratit të Komunës;

DSHPJK;

Dosjes së DUPM-së



Faqe 5 nga 5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net